

PROCESVERBAL
nga seanca e 8-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 01.03.2024

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski .

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të pranishëm nga Shërbimi Profesional nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, mr. Emilija Janevska, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, Goran Radunoviq, Maja Damevska, Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë: Përfaqësues të mediave të TV SHUTEL Shkup – Antonie Stojçeski dhe Radio ALEKSANDAR MAKEDONSKI Kërçovë – Ilija Tanevski.

Z. Petrushevski hapi seancën e 8-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 15:45 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Z. Petrushevski njoftoi se propozimi për heqjen e leles për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO USKANA – PLUS eksport-import SHPKNJP Kërçovë, do të shtyhet deri të hënën, 04.03.2024.

Z. Ajdini, për arsye teknike, në lidhje video-konferencë është përfshirë vetëm nëpërmjet lidhjes audio.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, (votimi i z. Ajdini ishte nëpërmjet audio linkut), me 6 vota “pro”, miratoi vi vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 7- të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 28.02.2024.

2. Propozim për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes për transmetim në radio të Radio PRO-FM Gostivar.
3. Propozime për ndërprerjen e procedurave për heqjen e lejes për transmetim TV dhe RA të transmetuesve.
4. Propozime për heqjen e lejes për transmetimin TV dhe RA të transmetuesve.
5. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të Ndërmarrjes Publike Radiodifuzive RADIOTELEVISIONI I MAQEDONISË Shkup - Televizioni i Maqedonisë - Shërbimi i dytë programor (TVM2), për shkëlqje të nenit 92 paragrafi (1) të LSHMAAV.
6. Kërkesë për pëlqim për ndryshimin ose plotësimin e më shumë se 20% të konceptit programor nga leja për transmetim në radio e parashtruar nga Shoqëria Tregtare Radiodifuzive RADIO 99 SHPKNJP Shkup, me Propozim-Vendim.
7. Informacion mbi pagesën e anëtarësimit vjetor në EPRA për vitin 2024.
8. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri, (votimi i z. Ajdini ishte me audio link), miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 7-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 28.02.2024, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Z. Trajçevski shpjegoi Propozimin për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes për transmetim në radio të Radios PRO-FM Gostivar. Ai shpjegoi se ky transmetues nuk e ka paguar faturën në afat prej 30 ditësh të dhënë (lëshuar) nga Agjencia për pagesë të kompensimit vjetor për lejen. Për këtë arsye, propozohet që të inicohet procedurë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, (votimi i z. Ajdini ishte me audio link), inicioi procedurën për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Radio PRO-FM SHPK Gostivar, PA 1 nr.08-95 datë 07.09.2023, për shkak të mospërbushjes së detyrimit nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, gjegjësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor për lejen e transmetimit në radio Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale sipas faturës së dorëzuar me nr.2024-100-0051 datë 11.01.2024.

Nëse transmetuesi në fjalë nuk paguan kompensimin vjetor për lejen për transmetim në radio, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, do miraton Vendim për heqjen e lejes për radiotransmetim të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive PRO-FM SHPK Gostiva, PA 1 nr.08-95 datë 07.09.2023, për shkëlqje të nenit 80 paragrafi (5) të LSHMAAV.

Z. Petrushevski iu drejtua shërbimit dhe tha që ta informojë transmetuesin saktësisht deri kur duhet të kryejë pagesën e kompensimit që të mos vijë në situatë që t'i hiqet leja.

Pika 3

Z. Trajçevski shpjegoi Propozimet për ndalimin e procedurave për heqjen e lejes për transmetim TV dhe RA të radiodifuzerëve. Ai ka shpjeguar se dy radiot dhe një televizion kanë kryer pagesën e plotë sipas faturës së lëshuar brenda afatit shtesë të përcaktuar me ligj. Për këtë arsye propozohet ndërprerja e procedurës së nisur.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri (votimi i z. Ajdini ishte me audio link) miratoi Vendim për ndalimin e procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TELEVISIONI KOÇANI-LD SHOKNJO Koçani, PA1 nr.08-44 datë 07.09.2023.

Në pajtim me Njoftimin për pagesën e kryer me nr.0503-783/2 datë 28.02.2024, Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TELEVISIONI KOÇANI-LD SHPKNJP Koçani, kompensimin vjetor për transmetim televiziv e ka paguar në tërësi, sipas faturës së dorëzuar me nr.2024-100-0014, datë 11.01.2024.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e mësipërm ta publikon në ueb faqen e Agjencisë.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri (votimi i z. Ajdini ishte me audio link), miratoi aktvendim për ndalimin e procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RFM SHPKNJP Shkup, PA 1 nr.08-75 datë 07.09.2023.

Në pajtimin me Njoftimin për pagesën e kryer me nr.0503-784/2 datë 28.02.2024, Shoqëria Tregtare Radiodifuzive RFM SHPKNJP Shkup, kompensimin vjetor për lejen e transmetimit në radio e ka paguar në tërësi, sipas faturës së dorëzuar me nr.2024-100-0035 të datës 11.01.2024.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e mësipërm ta publikon në ueb faqen e Agjencisë.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri, (votimi i z. Ajdini ishte me audio link) miratoi aktvendim për ndalimin e procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO VALANDOVO SHPK Valandovë, PA1 nr.08-90 datë 07.09.2023.

Në pajtim me Njoftimin për pagesën e kryer me nr.0503-786/2 datë 29.02.2024, Shoqëria Tregtare Radiodifuzive RADIO VALANDOVO SHPK Valandovë, kompensimin vjetor për lejen e transmetimit në radio e pagoi në tërësi, sipas faturës së dorëzuar me nr. 2024-100-0046 , datë 11.01.2024.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e mësipërm ta publikon në ueb faqen e Agjencisë. .

Pika 4

Z. Petrushevski, në lidhje me propozimet për heqjen e lejes për transmetim TV dhe RA të radiodifuzerëve, njoftoi se vendimi për RA Uskanë do të shtyhet sipas diskutimit nga seanca e kaluar. Ai propozoi që për tre transmetuesit e mbetur të ketë një diskutim dhe votimi të bëhet për secilën media veç e veç.

Z. Trajçevski shpjegoi se tre transmetuesit në fjalë, TV Shutel nga Shkupi, RA ALEKSANDAR MAKEDONSKI nga Kërçova dhe RADIO HIT nga Shkupi kanë llogari të

bllokuara për një periudhë të gjatë kohore. Me TV Shutel janë bërë disa kontakte, si sot ashtu edhe ditët e fundit. Sepse faturat janë lëshuar në fillim të janarit të këtij viti dhe tashmë kanë kaluar dy muaj, që do të thotë se ASHMA u ka dalë në ndihmë dhe u ka dhënë kohë të mjaftueshme për të shlyer borxhin. Gjatë kësaj periudhe ata patën mundësinë të zgjidhin problemin për të paguar lejen e transmetimit. Në ndryshimet në Ligjin për Disiplinë Financiare, që ka hyrë në fuqi, masat janë shumë rigorozë për ata që nuk e respektojnë ligjin, pra sjell pasoja dhe sanksione të rënda për subjektet që e shkelin atë. Përfaqësuesi i TV Shutel tha se është në bisedime me ZAMP për të hequr bllokimin e llogarisë në mënyrë që ai të paguajë kompensimin, dhe më pas të rregullojë mënyrën e shlyerjes së detyrimeve ndaj ZAMP. Në anën tjetër, ai ka shpjeguar se Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nuk lejon shtyrje të mëtutjeshme të afateve për pagesën e kompensimit, për shkak se të gjithë transmetuesve iu dhanë 15 ditë shtesë që sot skadon dhe që në këtë afat duhej të kryhej pagesa. Nëse arrijnë të zhblokojnë llogarinë të hënën, më 4 mars 2024, do të mund të kryejnë pagesën ndaj Agjencisë për borxhin. Vendimi duhet të botohet në Gazetën Zyrtare të RMV-së, por meqë është e premtë, fundi i javës së punës, nëse paguajnë të hënën, vendimi ende nuk do të publikohet në Gazetën Zyrtare, sepse të hënën është herët për t'u botuar. Me këtë, borxhi ndaj Agjencisë do të jetë i njëjtë, nuk do të duhet të pagohen shpenzimet për publikimin në Gazetën Zyrtare të RMV-së. Nëse nuk paguajnë të hënën, me padi para Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditësh, mund ta kthejë lejen dhe këto shpenzime janë minimale. Mundësi të tjera ligjore për shtyrjen e afatit nuk ka. TV Shutel ka kryer pagesë nga një firmë tjetër dhe RA ALEKSANDAR MAKEDONSKI si person fizik, por pagesat e tilla janë kthyer menjëherë nga Agjencia sepse janë të kundërligjshme dhe konsiderohen si shkelje e rëndë e ligjit dhe nuk mund të pranohen nga ASHMA-ja. Edhe një herë ai ka shpjeguar se nuk ka mundësi për shtyrje të mëtejshme.

Z. Petrushevski tha se ky shpjegim i drejtorit vlen edhe për RA ALEKSANDAR MAKEDONSKI. Ai shpjegoi se në të kaluarën ka pasur raste të tilla kur në bazë të ligjit, Këshilli duhet të merrte vendim për heqjen e lejes dhe më pas, nëse bëhej pagesa, transmetuesi pas procedurës gjyqësore në afat prej 30 ditësh me një padi, rifitoi lejen dhe mediumi u ruajt. Ai ka shpjeguar se anëtarët e këtij Këshilli për shumë vite kanë qenë me drejtorin dhe shërbimin, dhe asnjëherë deri më tani nuk ka pasur situatë ta shkelin ligjin. Prandaj nuk e kanë të lehtë të marrin një vendim të tillë, por sipas ligjit nuk kanë zgjidhje tjetër. Gjithçka që ka qenë në kompetencën e tyre është bërë, gjithçka që është e mundur do të bëhet, nëse do të gjenden mundësi që të hënën të kryhet pagesa, Këshilli do të caktojë urgjentisht seancë dhe procedurat do të zgjidhen në mënyrë pozitive.

Z. Fidanoski tha se i vjen keq që në seancë po diskutohen për pika të tilla, sepse ato janë gjithmonë të komplikuar dhe të vështira për t'u diskutuar kur duhet të vendoset për heqjen e lejes dhe Këshilli sipas ligjit duhet ta bëjë këtë, përndryshe do ta shkel ligjin. Ai vuri në dukje se në të kaluarën ka pasur situata me transmetues të cilët brenda 30 ditëve me padi para Gjykatës Administrative me kompensim të paguar plotësisht e kanë kthyer lejen dhe praktikisht kanë vazhduar të funksionojnë si media. Ai tha se i inkurajon transmetuesit që ta bëjnë këtë, sepse atë që tha drejtori Trajçevski dihet se janë bërë të gjitha përpjekjet dhe afatet që Agjencia si rregullator mund t'i japë për tejkalimin e situatës, por nuk duhet ta shkelin ligjin.

Z. Petrushevski tha se për të mos i mashtruar mediat që po dëgjojnë, kërkoi nga drejtori që edhe një herë të sqarojë se kjo është mirë të bëhet të hënën. Ai përmendi një mundësi prej 30 ditësh dhe i kërkoi të sqarojë, a janë këto procedura të ndryshme apo është e njëjta procedurë?

Z. Trajçevski shpjegoi se vendimi i sotëm i Këshillit për heqjen e lejes duhet të publikohet në Gazetën Zyrtare të RMV-së. Meqenëse nesër është e shtunë, pastaj e dielë, ditë jo pune, vendimi për vikend nuk mund të dërgohet në Gazetën Zyrtare. Vetëm botim në Gazetën Zyrtare sjell harxhime financiare. Nëse paguajnë të hënën, vendimi ende nuk do të publikohet në Gazetën Zyrtare dhe më pas me kthimin e lejes nuk do të duhet të paguajnë mjete shtesë, gjegjësisht ato mjete që Agjencia do t'i japë për botimin e vendimit në Gazetën Zyrtare për heqjen e lejes. Nëse këtë nuk e bëjnë të hënën, Vendimin për heqjen e lejes do të dërgohet në Gazetën Zyrtare për botim, më pas nëse në afat prej 30 ditësh e kryejnë pagesën, duhet të paguajnë Vendimin për heqjen e lejes që është publikuar në Gazetën Zyrtare dhe një Vendim tjetër me të cilin anulohet Vendimi për heqjen e lejes, i cili gjithashtu do të botohet në Gazetën Zyrtare. Ato shpenzime shtesë do të duhet t'i paguajë sërish transmetuesi, në këtë rast TV Shutel, RA Aleksandar Makedonski. Pra, nëse e bëjnë pagesën të hënën, kostot e tyre do të ulen në mënyrë drastike, sepse do t'u duhet të paguajnë vetëm kompensimin (tarifën) e lejes dhe nuk do të duhet të paguajnë shpenzimet për botim të dy vendimeve në Gazetën Zyrtare.

Z. Petrushevski tha se është mirë që kjo është sqaruar për vetë transmetuesit. Ai me qëllim e hapi këtë diskutim sepse përfaqësuesit e TV Shutel dhe RA Aleksandar Makedonski kanë të drejtë ta përcjellin seancën, por jo të diskutojnë. Ai shpjegoi se tani do t'i qasen pjesës më të vështirë, shpreson që transmetuesit ta shfrytëzojnë mundësinë, mediat duhet të ekzistojnë, nëse nuk do t'i ketë pse do të ekzistonte Agjencia.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, (votimi i z. Ajdini ishte me audio link) miratoi Vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv, PA1 nr. 08-18 datë 07.09.2023 të Shoqërisë Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, për shkak të mos pagesës së kompensimit vjetor për lejen e transmetimit televiziv në afatin e përcaktuar me ligj - 30 ditë nga dita e pranimit të faturës nr. 2024-100-0011 datë 11.01.2024. (nr ynë.ark.0503-172/1 datë 11.01.2024).

Spektori për Çështje Juridike dhe Furnizim Publik duhet ta informojë ORRPKE-në me të cilën transmetuesi ka lidhur marrëveshje se Këshilli i Agjencisë ka marrë Vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup.

Spektori për përkrahje të punës së drejtorit dhe Këshillit vendimin e mësipërm ta publikon në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", në ueb faqen e Agjencisë dhe në dy gazeta ditore, prej të cilave njëra është në gjuhën e bashkësive joshumicë, por që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri, (votimi i z. Ajdini me audio link) miratoi Vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio, PA1 nr.08-102 datë 07.09.2023 të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO ALEKSANDAR MAKEDONSKI Ilija Tanevski Kërçovë SHPKNJP, për shkak të mos pagesës së kompensimit vjetor për lejen për transmetim në radio në afatin e përcaktuar ligjor - 30 ditë nga dita e pranimit të faturës me nr. 2024-100-0055 datë 11.10.2024. (nr.ynë ark.0503- 232 /1 datë 11.01.2024) .

Spektori për përkrahje të punës së drejtorit dhe Këshillit, vendimin e mësipërm ta publikon në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", në ueb faqen e Agjencisë dhe në dy gazeta ditore, prej të cilave njëra në gjuhën e bashkësive joshumicë, por që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

- Këshilli i Agjencisë njëzëri, (votimi i z. Ajdini ishte me audio link), miratoi Vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio, nr.08-78 datë 07.09.2023 të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO HIT FM SHPKNJP Shkup, për shkak të kompensimit vjetor të pa paguar për lejen për transmetim në radio në afatin e përcaktuar ligjor - 30 ditë nga dita e pranimit të faturës me nr. 2024 -100-0038 datë 11.01.2024. (nr.ynë ark.0503-201/1 datë 11.01.2024).

Spektori për përkrahje të punës së drejtorit dhe Këshillit, vendimin e mësipërm ta publikon në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", në ueb faqen e Agjencisë dhe në dy gazeta ditore, prej të cilave njëra në gjuhën e bashkësive joshumicë, por që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Z. Petrushevski shprehu keqardhjen që Këshilli duhet t'i votojë këto vendime për heqjen e lejes, në të kundërtën anëtarët e Këshillit do të përfundonin në gjykatë.

Pika 5

Udhëheqësja e Spektorit për Çështje Programore, mr. Emilija Janevska shpjegoi Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje të Ndërmarrjes publike radiodifuzive RADIOTELEVISIONI I MAQEDONISË Shkup - Televizioni i Maqedonisë - Shërbimi i dytë programor (TVM2), për shkelje të nenit 92 paragrafi (1) të LSHMAAV. Ajo shpjegoi se shkelja është konstatuar nga mbikëqyrja e rregullt programore, e realizuar në shkurt të këtij viti. Nga kjo mbikëqyrje është konstatuar shkelja e detyrimit për transmetim të së paku 40% të veprave audiovizuale maqedonase në bazë ditore. Ditën e analizës radiodifuzeri ka transmetuar 35,64%, pra ka transmetuar për 57 minuta e 48 sekonda më pak program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase. Për këto arsye, propozohet që Këshilli i Agjencisë të marrë aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike, me afat respektimi prej 20 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit dhe më pas të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të kontrolluar nëse transmetuesi ka harmonizuar punën e tij me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Ajo ka thënë se TVM2 ka dërguar edhe deklaram që i është bashkangjitur materialeve, në të cilën theksojnë se shkelja ka qenë rezultat i mosrespektimi dhe se programi tashmë është përshtatur sipas vërejtjeve nga Raporti.

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer të rregullt programore nr.1001-934/1 datë 20.02.2024 dhe njëzëri (votimi i z. Ajdini u bë përmes audio linkut), konstatoi që Ndërmarrjes Publike Radiodifuzive RADIOTELEVISIONI I MAQEDONISË Shkup - Televizioni i Maqedonisë - Shërbimi i dytë programor (TVM2), t'i shqiptojë masë vërejtje publike për shkelje të nenit 92 paragrafi (1) të LSHMAAV, sepse më 2 shkurt 2024 nuk ka transmetuar së paku 40% program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase.

Në pajtim me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës nr. 01-4139/1 datë 07.11.2022, është urdhëruar që në afat prej 20(njëzet) ditësh nga data e pranimit të Aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të hartojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendim për vërejtje publike të kryer mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Sektorit për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e mësipërm ta publikon në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 6

Udhëheqësja e Sektorit për çështje programore, mr.Emilija Janevska, e shpjegoi Kërkesën për pëlqim për ndryshimin ose plotësimin e më shumë se 20% të konceptit programor nga leja për radiotransmetim të dorëzuar nga Shoqëria Tregtare Radiodifuzive RADIO 99 SHPKNJP Shkup, me Propozim-vendim. Shpjegoi se kjo kërkesë është nga RADIO 99 nga Shkupi, ish Radio Haraçina. Kërkesa është marrë më 19 shkurt të këtij viti, me të cilën kërkon të plotësojë konceptin programor në lidhje me gjuhën e transmetimit të shërbimit programor dhe në lidhje me shtrirjen e programit. Kjo paraqet një ndryshim prej më shumë se 20% të konceptit programor dhe për këtë arsye është e nevojshme që Këshilli i Agjencisë të japë pëlqimin e tij. Radio 99 deri më tani transmetonte program vetëm në gjuhën shqipe dhe vëllimi i programit të konceptit programor, që është pjesë përbërëse e lejes së saj, arrin në 4 orë në javë. Në kërkesën për pëlqim transmetuesi kërkon që përveç në gjuhën shqipe të lejohet të transmetojë program dhe në gjuhën turke dhe për të rritur volumin e programit të tij, pra nga 4 orë të rritet në 23 orë e 50 minuta në nivel javor. Ndërkaq, nuk do të ketë ndryshime në strukturën e muzikës sipas llojeve dhe zhanreve, as në strukturën e pjesës së folur të programit sipas llojeve të programit. Ajo shpjegoi se sektori konsideron se ndryshimi i kërkuar paraqet shtesë dhe përforsim të detyrimeve të pranuar më parë të transmetuesit dhe do të kontribuojë në pasurimin e ofertës së tij programore dhe në këtë mënyrë pasurimin e pluralizmit kulturor. Për këto arsye sugjerohet që Këshilli të pranojë propozimin dhe të marrë vendimin e propozuar, e më pas Agjencia të japë pëlqimin për leje për transmetim në radio.

Këshilli i Agjencisë miratoi Kërkesën për pëlqim për ndryshimin ose plotësimin e më shumë se 20% të konceptit programor nga leja për radiotransmetim, të dorëzuar nga Shoqëria Tregtare Radiodifuzive RADIO 99 SHPKNJP Shkup (nr ynë.ark.0306-910/1 datë 19.02.2024).

Këshilli i Agjencisë njëzëri, (votimi i z. Ajdini ishte me audio link), miratoi Vendim për dhënien e pëlqimit për ndryshimin dhe plotësimin e më shumë se 20% të konceptit programor të lejes për transmetim në radio, PA1 nr.0802-37, datë 07.02.2024 të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO 99 SHPKNJP Shkup , në lidhje me gjuhën e transmetimit, pra përveç transmetimit të programit në gjuhën shqipe, transmetuesi të transmeton program dhe në gjuhën turke dhe për të rritur volumin e programit të tij, pra nga 4 orë të rritet në 23 orë e 50 minuta në nivel javor.

Sektorit për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, vendimin e mësipërm ta publikon në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 7

Z. Trajçevski shpjegoi Informacionin për pagesën e anëtarësimit vjetor në EPRA për vitin 2024. Ai ka shpjeguar se mjetet duhet të paguhen jo më vonë se 12.03.2024, ndërsa anëtarësimi nga viti i kaluar është rritur për 300 euro në vit, me përjashtim të rregullatorëve të vegjël që kanë më pak se 5 të punësuar.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, (votimi i z. Ajdini ishte me audio link) pranoi Informacionin për pagesën e anëtarësimit vjetor në EPRA për vitin 2024, nr.0503-253/2 datë 29.02.2024.

Sektori për financa dhe logjistikë të paguajë mjetet në vlerë prej 3.900 euro për anëtarësimin vjetor të Agjencisë në EPRA për vitin 2024, më së voni deri më 12.03.2024.

Pika 8

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**